



**AAC- KE, WORKSHOP
"RRITJA E NIVELIT TË
KOORDINIMIT TË SLOTEVE"**
AAC në bashkëpunim me 2
ekspertët e njohur gjerman
pjesë e TAIEX...

faqe 2



**AAC ÇERTIFIKATË ISO DHE
VLERËSIM EKSELENCE NGA
ICAO BRËNDA 2018**
Sfidat kryesore të AAC për
2018, marrja e çertifikatës ISO
brënda vitit...

faqe 3

Qershor 2018 - Botimi II

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



OPINION
NGA EDA GAZHELI

**"E ARDHMJA E
TRANSPORTIT AJROR
DO TË JETË EDHE MË
EKOLOGJIKE"**

faqe 5

STATISTIKA

**211.651 PASAGJERË
GJATË MUJIT PRILL**

PRILL 2018 Referuar të
dhënave zyrtare të Autoritetit të
Aviacionit Civil në Aeroportin
Ndërkombëtar "Nënë Tereza" në
muajin Prill 2018 regjistrohet një
fluks në rritje po ta krahasojmë
me muajin Prill të 2017...

TË REJAT E FUNDIT

**TAKIM PËR ZONËN
E PËRBASHKËT
EUROPIANE NË
AVIACION**

BRUKSEL Drejtori i Autoritetit të
Aviacionit Civil shqiptar Krislen
Kerri, mori pjesë në Mbledhjen
e Komitetit të Përbashkët të
Marëveshjes Shumëpalëshe për
krijimin e Zonës së Përbashkët
Evropiane të Aviacionit, që u
zhvillua në Bruksel...



RAPORTI I PERFORMANCËS

TABELA ME ANULLIMET DHE VONESAT

Duke e krahasuar me 4 mujorin e parë të
2018, numri i fluturimeve të vonuara dhe
anulluara vijon të jetë i konsiderueshëm

faqe 6

KOMPANIA	ANULLIME	VONESA MBI 2 ORË
ERNEST SPA	2	6
ADRIA AIRWAYS	2	-
ALITALIA	2	-
AUSTRIAN AIRLINES	1	-
LUFTHANSA	1	-
BLUE PANORAMA	-	4
SMALL PLANET	-	2
ALBAWINGS	-	2
WIZZ AIR	-	-
AIR SERBIA	-	-
MISTRAL	-	-
VOLOTEA	-	-
BRITISH AIRWAYS	-	-
AEGEAN	-	-
TURKISH AIRLINES	-	-

AAC- KE: TAIEX WORKSHOP "RRITJA E NIVELIT TË KOORDINIMIT TË SLOTEVE"

Autoriteti i Aviacionit Civil në bashkëpunim me 2 ekspertët e njohur gjerman pjesë e TAIEX (Instrumenti për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim Informacioni i Komisioni European), zhvilluan për 2 ditë "workshop-in", me temë "Përmirësimin e Shërbimeve Aeroportuale, Rritja e Nivelit të Koordinimit të Sloreve dhe Liberalizimi i Shërbimeve në Tokë", në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza. Ekspertët gjerman Dieter Wilken inxhinier i cili trajton kërkimet për transportin dhe trafikun me mbi 40 vjet eksperiencë në këtë fushë, si dhe Dr. Sven Maertens, prezantuan mënyrat si operojnë aeroportet në Bashkimin European, dhe rrugët që mund të ndiqen në rastin e Shqipërisë, për të përmirësuar shërbimet aeroportuale, por edhe për të rritur nivelin e koordinimit të sloreve dhe atë operacional të aeroportit.



Në foto:
Drejtori i AAC z. Krislen Keri dhe 2 ekspertët gjermanë

KERI: SYNOJMË RRITJEN E NIVELIT TË KOORDINIMIT TË SLOTEVE

Drejtori i AAC Krislen Keri, tha se për autoritetin është me shumë rëndësi rritja e cilësisë së shërbimeve aeroportuale, duke filluar me rritjen e nivelit të koordinimit të sloreve dhe shërbimeve në tokë. Duke patur parasysh këtë objektiv, Keri tha se AAC në bashkëpunim me grupet e interesit ka filluar nga puna për të përgatitur

terrenin me qëllim rritjen e nivelin e koordinimit të sloreve, nga niveli 1 që është aktualisht në nivelin 3. Sipas Kerit, aktualisht duhet zgjidhur problemi i sloreve, sidomos gjatë sezonit të pikut, dhe për këtë arsye rritja e nivelit të koordinimit të sloreve, do të shërbejë zgjidhjes dhe funksionimit më të mirë të shërbimeve

aeroportuale. Një tjetër sugjerim nga ana e ekspertëve kishte të bënte me liberalizimin e shërbimeve në tokë, duke parë rritjen e numrit të pasagjerëve. Në këtë takim përveç përfaqësuesve nga AAC, morën pjesë edhe përfaqësues të disa kompanive ajrore që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".



Në foto:
Përfaqësues të AAC dhe kompanive ajrore gjatë workshop-it

BRUKSEL: TAKIM PËR ZONËN E PËRBASHKËT EUROPIANE NË AVIACION

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar Krislen Keri, mori pjesë në Mbledhjen e Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes Shumëpalëshe për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, që u zhvillua në Bruksel, me prani të përfaqësuesve të lartë të EASA. Gjatë diskutimeve, Keri tha se AAC do të të jetë e gatshme për të pritur një ekip vlerësues nga ky komitet në vitin 2019, që do përkojë edhe me miratimin e Kodit Ajror me aktet nënligjore. Drejtori i AAC Keri, ngrii shqetësimin dhe problematikën që hasin pasagjerët shqiptar me disa linja ajrore të licësuara në një vend anëtar në BE, që janë jashtë mbikqyrjes së AAC. Keri tha se pavarësisht se kjo është një marrëdhënie kontraktuale mes shoqërive përkatëse ajrore dhe

pasagjerëve, autoritetet kompetente si ato të BE-së dhe ato të palëve të asociuara të marrëveshjes, duhet të garantojnë zbatimin e akteve rregullatore në fuqi për të drejtat e pasagjerëve. Ndërkohë që AAC, **KERI: KOMPANITË AJRORE TË RESPEKTOJNË PASAGJERËT SHQIPTAR**



ka filluar prej kohësh një fushatë të gjerë për mbrojtjen e të drejtave të

pasagjerëve. Në tryezën e punimeve u diskutua edhe për sigurinë në aviacion, dhe programin që po ngrihet nga BE bazuar në risk, që do të thotë se shtete të veçanta duhet të standartizojnë procedurat e inspektimit. Vlerësimi i riskut do të përfshijë edhe pikat e kontrollit të sigurisë. Ndryshimet në legjislacionin e sigurisë do të përfshijnë edhe çështje si siguria e hapësirës tokësore, kërcënimi i brendshëm dhe kërcënimi kibernetik, që aktualisht nuk janë të rregulluara, por të orientuara për rregullim nëpërmjet rekomandimeve të ECAC. Në takim palët u angazhuan që të vijnë mbeshtetja për zgjerimin e shteteve pjesëmarrëse në iniciativën "One-Stop Security", në të cilën edhe Shqipëria ka aplikuar. Në takim u vu theksi tek transpozimi i rregullores për të kaluar në fazën tjetër.



AAC ZHVILLON MBLEDHJE VJETORE NË KORÇË, DISKUTOHEN OBJEKTIVAT PËR 2018

KERI: BRËNDA 2018 TË MARRIM ÇERTIFIKATËN E EKSELENCËS NGA ICAO



Foto:
Gjatë aktivitetit dhe prezantimit të objektivave.

Stafi i Autoritetit të Aviacionit Civil ka zhvilluar një mbledhje 2-ditore në qytetin e Korçës, në të cilën secila drejtori paraqiti ecurinë e nismave për pjesën e mbetur të 2018 dhe objektivat për vitin 2019. Gjatë diskutimeve Drejtori i AAC Krislen Keri, tha se gjatë këtyre 6 muajve të parë janë ndërmarrë një sërë reformash që lidhen me ristrukturimin e drejtorive të autoritetit, duke e përshtatur me ato të vendeve të zhvilluara të BE-së, por edhe në fushën e të drejtave të pasagjerëve. Me strukturën e re AAC do të ketë një ndarje bazuar me 5 drejtori kryesore. Duke folur për sfidat që institucioni ka për 2018, Keri renditi si pika kryesore marrjen e çertifikatës ISO brënda 2018 dhe vlerësimin me çertifikatë ekselence nga ICAO.

Drejtoritë e reja në AAC, paraqitën programet e tyre afatshkurtër dhe afatmesën, që lidhen me përmirësimin e funksionimit të Autoritetit në sektorët e licësimin, të drejtave të pasagjerit, sigurisë në aviacion etj.





E ARDHMJJA E TRANSPORTIT AJROR DO TË JETË EDHE MË EKOLOGJIKE


Eda Gazheli

Drejtor i Drejtorisë së Aeroporteve - AAC



Dikur të udhëtoje me avion ishte jo vetëm një eksperiencë e rrallë, por edhe një shërbim që ofrohej elitave. Bileta ishin të shtrenjta, fluturimet ishin më pak frekvente dhe destinacionet më të centralizuara. Liberalizimi i tregut, kompanitë me kosto të ulët dhe zhvillimet ekonomike që u mundësuan edhe më të varfërve akses në karta krediti dhe huamarrje e bënë transportin ajror, mediumin më popullor dhe masiv të transportit. Sot preferojmë transportin ajror, jo vetëm për shkak të shpejtësisë dhe leverdisë, por edhe prej koston mjaft të ulët. Në vendet e zhvilluara, udhëtimi me tren mes qyteteve kushton më shumë, sesa me avion. Transporti hekurudhor e ka bërë me kohë kthesën për të adaptuar teknologji më të gjelbra. Trenat elektrike janë mjetet më të pastra, ndaj po shihen gjithnjë më shumë si mjeti i preferuar i elitave konshiente për ndotjen individuale dhe kontributin e gjithësecilit për të ruajtur ambjentin. Trenat kushtojnë më shumë dhe mbërritja në destinacion kërkon më shumë kohë. Masivizimi dhe ulja e koston në transportin ajror ka ndikuar fuqishëm në zhvillimin e ekonomisë. Më shumë destinacione sot janë të lidhura në rrugë ajrore duke bërë të mundur shkëmbimet e mallrave dhe transportin e njerëzve. Aq i shpejt u bë ky ndryshim sa sot nuk është çudi të dëgjosh për njerëz që jetojnë në Europën Lindore dhe punojnë 5 ditë të javës në Bruksel, Londër, apo Frankfurt. Ndërtimi i aeroporteve të reja është gjithmonë një lajm i pritur në dy mënyra të ndryshme. Lajm i jashtëzakonshëm për zhvillimin ekonomik, por pak pesimist për ambientalistët dhe politikbërjen rajonale. Aeroportet e reja pa diskutim që krijojnë vende pune dhe ndikojnë shumë në rritjen e ekonomisë lokale. Por fluturimet frekvente

mund të jenë një faktor ndotës për ambjentin argumentojnë ambientalistët. Politikbërësit rajonalë i gëzohen perspektivës së hapjes së vendeve të reja të punës, por nga ana tjetër shqetësohen se mos shkurtimi i distancave ajrore mund të sjellë një konkurrencë më të fortë për tregun vendas të punës. Krahu i punës në tregun liberal të konkurrencës mund të vijë nga kudo dhe rajoni nuk mund të diskriminojë më të aftin. Këto janë dilema që vetëm zbatimi në praktikë mund të zgjidhë. Shqetësimit



të parë, atij të ambientalistëve, Industria e Aviacionit i është përgjigjur fillimisht me strategji në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe përmes tarifave respektive për ndotjen. Një ekonomi e zhvilluar duhet t'u krijojë mundësi shtetasve të zgjedhin. Sot nuk mundet që në mënyrë arbitrare të ndalosh vozitjen e makinave qoftë edhe për 1 km rrugë. Informimi i vazhdueshëm lidhur me statistikat e ndotjes në qytete duhet të orientojë politikbërjen dhe të prekë në mënyrë vendimtare ndërgjegjjen qytetare. Një nga aspektet më të bukura të punës në Aviacion është njohja nga afër me mënyrën sesi po evoluon kjo industri. Sot nuk po punohet vetëm për të shtuar numrin e destinacioneve, por edhe për t'i bërë aeroportet qendra

të fuqishme, punësimi, inovacioni, koneksioni, shërbimesh ekselente ku konsumatori mund ta shohë e prekë nga afër të ardhmen. E teksa prodhuesit e avionëve po punojnë për të gjetur mënyra më ekologjike për të fluturuar, si për shembull avionë elektrikë apo karburante që nuk ndotin, arkitektët nga ana tjetër punojnë për të ndërtuar aeroporte që janë më të favorshme për mjedisin. Duket si një mision i pamundur, pasi aeroportet konsumojnë mjaft energji, por një kombinim i vendosmërisë dhe aftësive brilante inxhinierike kanë filluar ta bëjnë këtë një realitet. Shumica e aeroporteve në botë përpiqen të ofrojnë më të mirën e shërbimeve të tyre. Ato janë mini oaze që tregojnë për zhvillimin e një vendi. Adaptimi i politikave dhe teknologjive më të gjelbra është pjesë e pandarë e kësaj industrie. Vendet Skandinave kanë qënë gjithmonë në pararojë e standarteve të zhvillimit dhe nuk përbën çudi që aeroporti i vlerësuar si më ekologjiku në botë, ndodhet në Norvegji. Terminali më i ri i Aeroportit të Oslos, të hapur pak kohë më parë, është modeli më brilant aktual. Ky terminal e ka rritur kapacitetin e aeroportit në 32 milion pasagjerë në vit. Drejtuesit e këtij aeroporti kanë treguar për mediat, sesi Aeroporti i Oslos e realizoi këtë duke siguruar materiale ekologjike, zgjidhje inovatore të përdorimit të energjisë dhe menaxhimit të mbetjeve. Firma që u ngarkua me projektin e terminalit të ri tregoi se objektivi ambicioz ishte që struktura e re ta përgjysmonte konsumin e energjisë. Muret dhe xhamat e aeroportit thithin në maksimum dritën e djellit, ndërsa materialet e ndërtimit janë që të gjitha nga pyje të menaxhuara me qëllim ripërtëritjen e tyre. Çdo material ndërtimi, jo vetëm që vjen nga ekonomia vendase, por edhe nuk rrezikon shterimin e rezervave natyrore të Norvegjisë.

Një tjetër element që e bën unik këtë terminal, është fakti që përdorimi i materialeve vendase i jep aeroportit edhe një identitet karakteristik nordik, në një kohë kur aeroportet në mbarë botën i ngjasojnë njëri-tjetrit. Një prej mekanizmave menaxhues tipik nordik, është sistemi i ftohjes. Në dimër, dëbora mblihet dhe depozitohet në depo e mbuluar me tallash për izolacion. Gjatë verës, uji nga dëbora e shkrirë përdoret për freskimin e ndërtesave të aeroportit. Në dimër ngrohja bëhet me energji termale natyrale. Një tjetër element i jashtëzakonshëm i arkitekturës së këtij terminali, është fakti që megjithëse aeroporti është më i madh, koha e mbërritjes më këmbë e pasagjerëve te Portat e Nisjes ka mbetur e njëjtë. Edhe Finlanda fqinje ka të njëjtat objektiva ekologjike. Deri në vitin 2020 kompania që menaxhon 21 aeroportet e vendit,

Finavia ka një program ambicioz për të qenë karbon neutrale. Autobusat dhe makinat e aeroportit do të jenë elektrike ose me karburante biologjike. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, përshtatja e aeroporteve me nevojat e domosdoshme të kohës mbetet një përpjekje që kërkon shumë investime, vendosmëri dhe angazhim shumë të madh nga ana e qeverive. India, një prej vendeve në zhvillim më ndotëse në botë, ka dhënë shembullin e saj me Terminalin 3 në aeroportin Indira Gandhi dhe aeroportin e ri ekologjik Galapagos. Në aeroportin e Dehlit, energjia dhe uji konservohen duke shfrytëzuar në maksimum dritën e diellit përmes paneleve diellore, uji i shiut depozitohet për t'u shfrytëzuar për freskim, ndërsa mbetjet menaxhohen nga një uzinë përpunimi e ndërtuar ngjitur me aeroportin. Aeroporti Galapagos, u ndërtua në

nje pjesë të madhe nga materiale të ricikluara dhe përdor 100 për qind energji diellore dhe nga turbina të erës. Aeroportet janë porta ku jo vetëm prekim dhe ndjejmë zhvillimin e shoqërive tona, por edhe vendet ku mund të projektojmë me sukses modelet e jetesës që do të trashëgojnë brezat e ardhshëm. Për një ekonomi më të fuqishme, kemi nevojë për më shumë rrugë dhe koneksione. Për më shumë vende pune na duhet një hapje më e madhe ndaj botës dhe aeroportet e reja e bëjnë këtë më së miri. A mund t'i ndëtojmë ato më ekologjike? Sigurisht që po. Nëse të gjithë kemi motivacionin dhe vendosmërinë për ta bërë këtë me burime natyrore të ripërtëritshme vendase, energji djellore dhe nga era si dhe menaxhim dhe riciklim të mbetjeve.

AAC MERR PJESË NË PANAIRIN E PUNËS ORGANIZUAR NGA “UET”

Autoriteti i Aviacionit Civil, ka marrë pjesë në panairin e Punës organizuar nga Universiteti Europian i Tiranës. Stenda e AAC-së, u vizitua nga shumë studentë kureshtar për mënyrën se si funksionon ky institucion, por edhe të interesuar për tu punësuar. Dhjetëra të rinj, morën informacion dhe komunikuuan me stafin e AAC, për fushat e operimit dhe mundësitë për punësim. Stafi i AAC-së, ju komunikoi të interesuarve ku janë sektorët me vendet vakante, që kërkojnë kualifikime dhe diplomë universitare në disa degë inxhinierike, financë dhe në atë juridike për të cilat duhet aplikuar pranë Departamentit të Administratës Publike. Në këtë edicion të 9-të të panairit të Punës organizuar nga UET, morën pjesë dhjetëra biznese dhe institucione të tjera.



Në Foto:
stenda e AAC në Panairin e Punës 2018

RAPORTI I PERFORMANCËS

Raporti i përformancës për muajin Maj, tregon ecurinë e secilës kompani ajrore, që lidhen me indikatorët e respektimit të orarit të nisjes dhe anulime të fluturimeve. Më poshtë është edhe tabela me kompanitë ajrore që kanë regjistruar numrin më të madh të vonesave dhe anulime të fluturimeve. Duke e krahasuar me 4 mujorin e parë të 2018, numri i fluturimeve të vonuara dhe anuluar vijon të jetë i konsiderueshëm.



KOMPANIA	ANULLIME	VONESA MBI 2 ORË
ERNEST SPA *	2	6
ADRIA AIRWAYS	2	-
ALITALIA **	2	-
AUSTRIAN AIRLINES	1	-
LUFTHANSA	1	-
BLUE PANORAMA	-	4
SMALL PLANET	-	2
ALBAWINGS	-	2
WIZZ AIR	-	-
AIR SERBIA	-	-
MISTRAL	-	-
VOLOTEA	-	-
BRITISH AIRWAYS	-	-
AEGEAN	-	-
TURKISH AIRLINES	-	-

Tabela përkatëse

SHËNIME

- * 1 VONESË DHE 1 ANULLIM PËR SHKAK TË GREVËS
- ** PËR SHKAK TË GREVËS

TË DREJTAT E PASAGJERIT

Gjatë muajit Maj, për shkak të vonesave dhe anulimeve, pasagjerë të shumtë kanë plotësuar formularët e ankimit duke kërkuar kompensimin e përcaktuar me rregulloret Europiane ku Shqipëria bën pjesë. Kështu duke u referuar në të dhënat zyrtare, formularët e ankimit të plotësuar janë si më poshtë. Ajo që bie në sy është se nga muajt e parë të fillimit të fushatës, pasagjerët po ndërgjegjësohen përditë e më shumë për të drejtat që ju takojnë, duke plotësuar formularët e ankimit si e vetmja mundësi për të përfutur kompensim.



KOMPANIA	DESTINACIONI	ARSYEJA	FORMULARË TË PLOTËSUAR
ADRIA AIRWAYS			
29.04.2018	TIA-FRA	ANULLIM	15 FORMULARË 32 PASAGJERË
AUSTRIAN AIRLINES			
03.05.2018	TIA-VIE	ANULLIM	11 FORMULARË 12 PASAGJERË

KOMPENSIME


Nga të dhënat zyrtare gjithashtu vjen një lajm pozitiv, ku kompania Blue Panorama ka kompensuar 10 pasagjerë të fluturimit të datës 01.12.2017 me destinacion qytetin e Veronës, Itali. Në total në 4 muajt e parë të 2018, numri i pasagjerëve të kompensuar nga kompanitë ajrore për shkak të vonesave mbi 2 orë ose anulime, shkon në 80 dhe kjo ndodh për herë të parë në 25 vitet e fundit. Ndërsa një numër i konsiderueshëm formularësh është plotësuar nga pasagjerët dhe janë në proces vlerësimi.

NUMRI PASAGJERËVE PËR MUAJIN PRILL

■ **PRILL 2018:** Referuar të dhënave zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", muaji Prill 2018 regjistron një fluks në rritje të numrit të pasagjerëve po ta krahasojmë me muajin Prill të 2017.

■ **PËRQINDJET:** Shifrat referojnë një numër prej 211,651 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë kësaj periudhe. Referuar të dhënave kompania ajrore "Blue Panorama" është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Prill 2018, me 22% të totalit. Ndjekur nga "Albawings" me 15% ndaj totalit, "Ernest Airlines" 14% të totalit dhe Alitalia 9% të totalit mujor.

■ **ITALIA:** Nisur nga këto të dhëna Italia vazhdon të zotërojë përqindjen më të madhe të tregut të transportit ajror për muajin Prill 2018, duke zënë 60% të totalit, ndjekur nga Turqia me 1%.




Grafiku:

Lëvizja e pasagjerëve që kanë udhëtuar për /nga TIA gjatë muajit Prill 2018, sipas kompanive ajrore.

■ **PRILL 2018:** Krahasuar me muajin Prill 2017, ka një rritje që në shifra konkrete shkon në 21,888 pasagjerë më shumë.

■ Po ta krahasojmë me muajin prill 2016 diferenca është 64,188 më shumë pasagjerë në 2018.




Grafiku:

Numri i pasagjerëve për muajin Prill gjatë 3 viteve të fundit:

LINJË E RE CHARTER

Në muajin Maj, listës së gjatë të destinacioneve ajrore i është shtuar edhe shteti i Izraelit. Duke filluar nga ky muaj, do të ketë fluturime charter direkte Tiranë-Tel Aviv dhe anasjelltas, çfarë besojmë do të ndikojë akoma më shumë në forcimin e raporteve mes 2 vendeve tona, si dhe do të shtojë numrin e turistëve. Fillimi i këtij itinerari të ri është dyfish pozitiv për vendin tonë, pasi kompania që ka filluar operimin është me flamurin shqiptar, duke treguar se Aviacioni Shqiptar po shënon rritje të performancës dhe përmirësim të shërbimeve.



AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT MAJ

Drejtoria e Mbikqyrjes së Shërbimit ajror organizoi një takim me fokus njohjen me rregulloren e re për aktivitetet e fluturimit me paragliding, parashutë, balonë dhe delta-plan në hapësirën ajrore shqiptare. Në takim u zhvilluan tematikat që lidhen me:

1. Regjistrimi subjekteve që kryejnë këto operime.
2. Njohjen me Rregullat e Ajrit për përdoruesit paraglider e delta-plan të hapësirës ajrore dhe ato VFR.
3. Njohja me zonat e kufizuara në



nivele të ulëta të hapësirës ajrore të këtyre përdoruesve.


4. Detyrimi i njohjes me Informacionin Aeronautik të Shqipërisë, AIP Albania.
5. Lajmërimi paraprak dhe koordinimi me OSHNA përpara i përket aktiviteteve të ndryshme velore dhe delta-plane.
6. Parandalimi i shkeljeve të rregullave të Ajrit.

Gjithashtu AAC ju ka dërguar gjithë grupeve të interesit bazuar edhe në ligjin për konsultim publik një kopje të rregullores së re “Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të Paraglajdeve dhe Deltaplaneve”. Gjithashtu për konsultim publik është dërguar dhe publikuar edhe draft rregullorja për operimin e droneve. Të dyja materialet janë publikuar në website të autoritetit dhe u ka shkuar për konsultim edhe grupeve përkatëse.

Autoriteti i Aviacionit Civil zhvilloi auditin ndjekës nga datat 28-31 Maj, tek ofruesi i shërbimeve të navigimit ajror AlbControl, si pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të AAC në monitorimin dhe përmbushjen e standarteve ndërkombëtare në fushën e navigimit ajror.



Drejtoria e Sigurisë në Aviacion ka mbyllur inspektimin “follow-up” në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” mbi Akses Kontrollin. Gjithashtu janë mbikqyrur nga inspektorët e DSA trajnimet e sigurisë sipas njoftimeve që kanë ardhur pranë AAC nga operatorët.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Aviacioni në Botë

FRANKFURT, INVESTIM 15 ML EU PËR TË ULUR KOHËN E PRITJES

Fraport, kompania që operon aeroportin e Frankfurtit në do të vendosë të shtojë pikat e kontrollit të sigurisë, për të reduktuar radhët e gjata në aeroportin më të madh në Gjermani. Iniciativa erdhi pas një numri të konsiderueshëm ankesash sidomos nga kompania ajrore Lufthansa. Drejtori i Financave duke folur për mediat tha se synimi është që të reduktohet koha e pritjes së pasagjerëve që në sezonin e pikut shkon në një mesatare rreth 40 minuta, duke e çuar në 10 minuta. Investimi që kap vlerën e 15 milion eurove, parashikon ndërtimin e një godine të vogël dhe shtimin e 10




pikave të kontrollit.

LONDËR, GATI INVESTIMI PËR TERMINALIN E RI NË AEROPORTIN HEATHROW

Pronarët e "Arora Group", zinxhirit të njohur të hoteleve kanë zyrtarizuar propozimin e tyre për ndërtimin e një terminali të ri në aeroportin Heathrow të Londrës. Arora Group, ka propozuar të ndërtojë atë që njihet si Terminali Perëndimor, që do të ketë një kapacitet vjetor deri në 50 milion pasagjerë. Investimi parashikohet të kapë vlerën e 14.4 miliard paund, dhe nëse fillon ndërtimi e bën të panevojshme zgjerimin e terminaleve 2 dhe 3. CEO i "Arora Group" Surinder Arora, tha se Aeroporti i Heathrow ka qenë për shumë vite monopol, por besojmë se oferta jonë do e bëjë më konkurrues dhe do ofrojë lehtësi për pasagjerët dhe kompanitë ajrore.

SHBA, MASA SHITESË PËR TË PËRBALLUAR FLUKSIN E VERËS

Drejtoria për Siguri dhe Transport në Shtetet e Bashkuara, ka marrë disa masa shtesë për të përballuar ditët



e pikut të fluksit të pasagjerëve që pritet të vijnë gjatë sezonit të verës. Sipas parashikimeve, do të jenë rreth 2.7 milion pasagjerë në ditë që do të udhëtojnë dhe për të përballuar me sukses këtë fluks, është parashikuar përdorimi i teknologjive. TSA është duke testuar skanerat 3D, që e bëjnë të panevojshme hapjen e çantave. Një masë tjetër pritet të jetë shtimi me rreth 1600 oficerë sigurie. Administrata e Presidentit Trump, gjithashtu ka rritur buxhetin për aplikimin e teknologjive nga TSA, për të përballuar fluksin e madh që pritet të kenë aeroportet amerikane, në veçanti në ditën e falenderimeve. Gjithashtu autoritetet e kontrollit do të kenë edhe listën me pothuajse 1 milion persona, të hartuar nga FBI, që dyshohet se janë të përfshirë në organizata terroriste.

KUBË, BIE AVIONI 105 VIKTIMA

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në ishullin e Kubës, ku një avion Boeing 737 ka rënë duke ju marrë jetën 105 personave që ndodheshin në bord. Avioni charter i kompanisë meksikane Global Airlines, kryente fluturime lokale dhe si destinacion kishte qytetin kubanez Holguin, kur vetëm pak minuta pas ngritjes pësoi një defekt teknik duke u anuar nga njëra dhe përplasur me tokën. Kompania Boeing, me anë të një njoftimi për mediat, shprehu ngushëllimet për familjarët, dhe u shpreh e gatshme të dërgojë një ekip me ekspertë për të hetuar për shkaqet e kësaj ngjarje të rëndë.

AUSTRALI 300 ML DOLLARË INVESTIME PËR TË FORCUAR SIGURINË NË AEROPORTE

Autoritetet Australiane kanë zyrtarizuar investimin prej 300 milion dollarësh për të përfunduar sistemet e sigurisë në aeroportet kryesore të vendit. Masa vjen nga frika e sulmeve terroriste veçanërisht të terroristëve që operojnë vetëm, ose siç njihen si "ujqërit e vetmuar". Ministri Australian për çështjet e brëndshme Peter Dutton, tha se kërcënimet terroriste e bëjnë të domosdoshme marrjen e masave, ndërkohë që agjensitë e inteligjencës kanë zbuluar disa raste ku ishin parashikuar sulme terroriste.

SHBA, MEMFIS DRONËT NË PËRDORIM PËR SIGURINË E AEROPORTIT

Aeroporti i Memfis ka filluar një projekt të ri pilot, duke përdorur dronët për disa operacione, duke filluar me kontrollin e perimetrit të aeroportit, zbulimin e objekteve të huaja. Pilotët do të njoftohet për praninë e dronëve. Gjithashtu një përdorim tjetër do të jetë nga FedEx, që në rast emergjence do ti përdor dronët për të transportuar pajisje të vogla. Por mesa duket ky është vetëm fillimi, pasi autoritetet lokale do ti përdorin për të çuar medikamente në disa zona të izoluara, por edhe për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë publike dhe monitorim të veprave infrastrukturore. Kjo nismë ka marrë edhe mbështetjen e administratës së presidentit Trump, për të integruar dronët në hapësirën ajrore amerikane.

IATA RRITE TË FLUTURIMEVE ME 9,5 % NË 3 MUJORIN E PARË 2018

Organizata Ndërkombëtare për Transportin Ajrore (IATA), në raportin e publikuar pak ditë më parë për 3 muajt e parë të 2018, tregon se ka një rritje me 9,5 % të numrit të pasagjerëve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas të dhënave të gjitha kontinentet është shënuar rritje me përjashtim të rajonit të Lindjes së Mesme. CEO dhe njëkohësisht Drejtori i "IATA" Alexandre de Juniac tha se: Kërkesa për transportin ajror vazhdon të mbetet e lartë dhe kjo lidhet me besueshmërinë në këtë biznes. Por për shkak të kostove në rritje, ne duhemi se niveli kaq i lartë do të bjerë disi në muajt në vijim, kjo për shkak të rritjes së kostove në veçanti çmimit të karburantit.